



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

*Shkurt, 2017*

Viti 2017 është vit i zgjedhjeve në SBASHK

### Takime të frytshme me anëtarësinë nëpër komunat e Kosovës




Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka marrë vendim që viti 2017 të jetë vit i zgjedhjeve duke filluar nga shoqatat sindikale e për të vazhduar në nivelin komunal e pastaj në nivelet arsimore.

Gjithashtu Këshilli Drejtues vendosi që:

1. Zgjedhjet në shoqata sindikale, pra në shkolla dhe njësi akademike të bëhen duke filluar në janar e deri më 15 korrik 2017
2. Zgjedhjet në nivele të Kuvendeve të SAF e SAM nëpër komuna ( nga 1 shtatori deri më 30 tetor)... (faqe 4)

Në mbrojtje të institucioneve arsimore dhe të personalitetit të mësuesit

**Mësuesi dhe shkolla kanë mision të shenjtë**



Fatkeqësisht edhe në Kosovë në kohët e fundit hetohen tendenca, me a pa qëllim, që të lëndohet personaliteti i mësuesit. Një pjesë e qeveritarëve ... (faqe 6)

Në disa komuna u mbajtën Kuvende pune të SAF e SAM

**Gatishmëri për realizimin e detyrave konkrete**



Me qëllim që të zhvillohet bashkëbisedë me anëtarësinë për të gjitha çështjet aktuale, po realizohet edhe agjenda ... (faqe 7)

Aktivitete të shtuara ndërkombëtare të SBASHK-ut

**Pjesëmarrje në punimet e Komiteteve të ETUCE dhe në EI**

Përkushtimi për realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe arritjet e vazhdueshme kanë bërë që SBASHK-u të gëzoj respekt ....(faqe 7)

Intervistë me kryetarin e SBASHK-ut , z.Rrahman Jasharaj

**Është nder të jesh kryetar i një sindikate siç është SBASHK-u**

*Janë bërë 3 vite që kur delegatët e Kongresit VI të SBASHK-ut i dhanë besimin Rrahman Jasharajt që të udhëheq Sindikatën më unike e më të fortë... (faqe 3)*



## Editorial

### Respekt për personalitetin e mësuesit tonë



SBASHK-u edhe këtë vit do ta kremtojë 7 Marsin, këtë datë të madhe për shkollën shqipe, me një ceremoni festive në Sallën e Pallatit të Rinisë në Prishtinë. Në këtë mënyrë shprehim respektin për punën e madhe që kanë bërë anëtarët e SBASHK-ut nëpër vite e dekada.

Ky solemnitet do t'i bëj bashkë 508 të punësuarit në arsim e që janë pensionuar nga prilli i vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti . Do të jenë në të njëjtin vend pishtarët e shkronjave shqipe dhe SBASHK-u në shenjë të respektit për punën e madhe të tyre në arsimimin e edukimin e brezave nëpër vite e dekada u ndanë nga

një orë dore dhe nga një mirënjohje. Kjo orë nuk është thjeshtë një mekanizëm që mat kohën, por është një kujtim modest, por shumë domethënës, për këta pishtarë të dijes. Kjo orë është simbolikë e kohës së gjatë që mësimsdhënësit tanë kaluan në klasë e pranë nxënësve të tyre. Duke shkruar orën me shkronjat e mëdha SBASHK, këtë njerëz të dijes do të kujtojnë ditët e lumtura në arsim, por edhe vitet e vështira e plot sfida. Mirënjohja do të jetë shprehje e respektit të SBASHK-ut për këta pishtarë të dijes .

Pra, dhurata nuk shikohet në vlerën materiale, por në respektin që ajo shpreh e dhuratat e SBASHK-ut përcjellin respektin e mijëra anëtarëve tanë kudo në Kosovë për kolegët tanë pensionistë dhe për punën e tyre të madhe.

E gëzofshin pensionin këta njerëz të mirë të dijes .

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)** përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



## Intervista

### Intervistë me kryetarin e SBASHK-ut , z.Rrahman Jasharaj



**Është nder të jesh kryetar i një sindikate siç është SBASHK-u**

*Janë bërë 3 vite që kur delegatët e Kongresit VI të SBASHK-ut i dhanë besimin Rrahman Jasharajt që të udhëheq Sindikatën më unike e më të fortë në Kosovë. Kjo nuk është edhe detyrë e lehtë sepse kërkon shumë punë e përkushtim. Jasharaj thotë se*

*ndjehet i nderuar që është kryetar i një sindikate siç është SBASHK-u. Ai në këtë intervistë tregon për sfidat, shqetësimet, dhe për arritjet.*

#### Arsimimi sot:

Vitet po ikin shpejt. Jeni tani e tri vite krye sindikalist i SBASHK-ut . Mësimdhënësit po thonë se e keni arsyetuar besimin e tyre?

#### Jasharaj

Është e vërtetë që vitet po ikin shpejt. Kur kthehem dhe shpalos kujtimet nëpër këto tri vite dhe bëj një analizë të sfidave, kërkesave dhe arritjeve dhe kur dëgjoj atë që e thonë kolegët e mi sindikalistë në takime me ta kudo në Kosovë ndjehem mirë sepse ata e vlerësojnë se unë jam munduar të jem vazhdimisht në krye të detyrës. SBASHK-u ka shënuar arritje të shumta në këto vite dhe gëzon respekt kudo në Kosovë. Të gjitha këto arritje janë rezultat i respektit e besimit të ndërsjellë dhe të unitetit të shkëlqyer të anëtarësisë së SBASHK-ut.

#### Arsimimi sot:

Në çka është fokusuar angazhimi i SBASHK-ut kohëve të fundit?

#### Jasharaj

Janë shumë angazhime dhe përpjekje për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. SBASHK-u është fokusuar veçmas në zgjidhjen e çështjes së tri pagave me rastin

e pensionimit të punëtorëve të arsimit dhe të tri pagave suplementare. Pasi që komunat nuk deshën që çështjen ta zgjedhin mirë e me dialog, SBASHK-u përgatiti dokumentacionin gjegjës dhe nisi proceduarat gjyqësore. Tani Gjykatat do ta sjellin vendimin meritore dhe jam i sigurt se ai vendim do të jetë pozitiv për ne. Angazhim të veçantë tani e sa kohë kemi bërë edhe rreth Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta. Pas shumë përpjekjesh kemi arritur të momenti që përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ajo e Financave, MASHT-i dhe përfaqësuesi i SBASHK-ut të zhvillojnë dialog për ligjin dhe ta përgatisin versionin e pranueshëm nga të gjitha palët dhe ta dorëzojnë në Qeveri dhe kështu të nis rrugëtimi i tij drejt Parlamentit. Një angazhim i madh dhe aktivitet i shkëlqyer ishte edhe ai lidhur me Projektligjin për pagat. Reagimi me kohë dhe i fuqishëm i SBASHK-ut bëri që Projektligji si i tillë, që ishte degradues e nënçmues për të punësuarit në arsim, mos të shkojë në Parlament. Vlerësoj lartë angazhimin edhe e të tjerëve, por veçoj angazhimin e kolegut Ymer Ymeri, i cili ka bërë një punë të shkëlqyer në takime me përfaqësues të MASHT dhe me Ministrin Yagcilar e kabinetin e tij dhe tani Qeveria ka versionin tonë , i cili punëtorin e arsimit e vë në pozicion më meritore. Janë edhe punë e angazhime të tjera me vlerë dhe për to vazhdimisht e kemi informuar anëtarësinë dhe opinionin në tërësi. Na gëzon shumë edhe fakti se kemi arritur suksese edhe në bashkëpunimin ndërkombëtar me sindikata simotra. SBASHK-u është pjesë aktive e të gjitha veprimtarive sindikale në ETUC dhe në EI.

#### Arsimimi sot:

Viti 2017 është vit i zgjedhjeve në SBASHK, si ka nisur ky aktivitet?

#### Jasharaj

Po është e vërtetë se viti 2017 është vit i zgjedhjeve në SBASHK. Ky aktivitet ka nisur mbarë. Është filluar me zgjedhjet nëpër shoqata sindikale dhe kemi

përgatitur një formular unik për tërë Kosovën që lidhet me zgjedhjet. Janë zhvilluar zgjedhje edhe në nivel të Kuvendeve të SAF e SAM në 4 komuna dhe në ato takime ka qenë një frymë e unitetit të shkëlqyer. Pra, aktiviteti ka nisur mbarë dhe , besoj , se ashtu edhe do të përfundojë.

## Arsimimi sot:

Si komunikoni me anëtarësinë, përmes personave të autorizuar, apo ju shkoni vet mes tyre?

## Jasharaj

Kemi komunikim të vazhdueshëm me anëtarësinë. Ata janë të informuar vazhdimisht për angazhimet dhe situatën aktuale. Një meritë të madhe në këtë e kanë edhe mediet, që kanë bërë informim korrekt për angazhimet dhe për gjithë aktivitetin e SBASHK-ut. Me anëtarësinë komunikojmë edhe përmes anëtarëve të Këshillit Drejtues, të cilët janë prezent në takimet e shpeshta të këtij organi, që është më i larti, mes dy Kongreseve, por me kënaqësi edhe unë shkoj në takime kudo nëpër komunat e Kosovës. Kam vërejtur se bashkëbisedat dhe takimet me anëtarësinë janë shumë të frytshme sepse kështu krijohet mundësia e informimit të saktë, por edhe marrja e ideve të reja nga anëtarët e SBASHK-ut. Për këto tri vite kam qenë se paku nga tri herë në secilën komunë në takimet me kolegët e mi sindikalistë.

## Arsimimi sot:

Pse duhet të aderojnë në SBASHK edhe ata pak mësime të tjerë që ende nuk janë pjesë e SBASHK-ut?

## Jasharaj

SBASHK-u e ka dëshmuar gjithmonë edhe përball sfidave të mëdha se është sindikatë serioze, e organizuar dhe mbrojtës i fuqishëm i të drejtave dhe kërkesave të punëtorëve të arsimit. Janë shënuar, këtë e pranojnë të gjithë, arritje të mëdha. Prandaj, angazhimet, përkushtimi dhe arritjet tona bashkë me unitetin e shkëlqyer janë fakte të mjaftueshme që duhet t'i kujtojnë edhe ata pak të punësuar në arsim e që nuk janë ende në SBASHK dhe të të dëgjojnë apelin tim që të jemi bashkë e në SBASHK.

## Arsimimi sot:

Edhe diçka në fund të kësaj interviste?

## Jasharaj

Duke shprehur respektin më të lartë për të gjithë pishtarët e dijes nëpër vite e dekada ju premtoj se SBASHK-u do të vazhdojë me përkushtim angazhimet për realizimin e kresave legjitime të të punësuarve në arsim.

## Gjatë muajit

Viti 2017 është vit i zgjedhjeve në SBASHK

### **Takime të frytshme me anëtarësinë nëpër komunat e Kosovës**

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut ka marrë vendim që viti 2017 të jetë vit i zgjedhjeve duke filluar nga shoqatat sindikale e për të vazhduar në nivelin komunal e pastaj në nivelet arsimore. Po ashtu janë mbajtur edhe Kuvende zgjedhore në disa komunat pasi kryetarët atje janë pensionuar. Në kuadër të këtij aktiviteti në Lipjan është mbajtur Kuvendi zgjedhor i SAF e SAM. Pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe drejtori i Drejtorisë Arsimore të Lipjanit, z. Rasim Hasani dhe nënkryetarët e SBASHK-ut, Lutfi Mani e Rexhep Sadiku, të shoqëruar nga juristi Blendor Shatri.



Drejtori i DKA-së, Rasim Hasani ka folur lidhur me bashkëpunimin korrekt të drejtorisë së tij me Sindikatën në përpjekje për zgjedhjen e mundshme të kërkesave të anëtarësisë kurse kryetari i deri tashëm Rrushtem Bublica ka paraqitur një raport pune duke u ndalur në momentet më të rëndësishme të aktivitetit sindikal në këtë komunë. Nën kryetarët e SBASHK-ut Lutfi Mani e Rexhep Sadiku bashkë me juristin Blendor Shatri kanë bashkëbiseduar me kryetarët e shoqatave sindikale të shkollave fillore e të mesme të Lipjanit Pjesëmarrësit kanë lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut dhe kanë marrë përgjigje në shumë pyetje të shtruara. Pas kësaj është kaluar në zgjedhjen e kryetarit të këtij Kuvendi. Kryetar i ri i këtij Kuvendi është zgjedhur Emrush Ahmeti .

### Kuvende zgjedhore edhe në Rahovec e Suharekë

Në takimin në Rahovec kanë marrë pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe drejtoresha e DKA-së , znj. Vjollca Vuçitërna.



Edhe në këtë takim është lavdëruar angazhimi dhe arritjet e SBASHK-ut dhe është zhvilluar një bashkëbisedë mes pjesëmarrësve dhe përfaqësuesve të SBASHK-ut për t'u dhënë përgjigje në shumë pyetje e për të ngritur edhe ide të reja në shërbim të anëtarësisë. Pas kësaj është bërë edhe zgjedhja e kryetarit të ri të Kuvendit të SAF e SAM për këtë komunë. Në mesin e 6 kandidatëve për postin e kryetarit në raundin e dytë me shumicë votash kryetar është zgjedhur Veli Morina.



Edhe në Kuvendin zgjedhor të SAF e SAM të Suharekës është shprehur unitet i fuqishëm dhe është lavdëruar angazhimi i SBASHK-ut. Kryetari i deri tashëm i këtij kuvendi , Sadik Shala , duke hapur punimet e këtij Kuvendi në fillim ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe ka falënderuar për pjesëmarrje kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe kryetarin e Kuvendit të Arsimit të Mesëm të Kosovës, Besnik Krasniqi. Ai pas kësaj ka paraqitur raportin e punës, që është aprovuar.



Në fjalën përshëndetëse kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka lavdëruar punën dhe aktivitetin shumë të suksesshëm të z. Sadik Shala , por edhe përkushtimin dhe unitetin e gjithë anëtarësisë sindikale në Suharekë. Ai në shenjë respekti për punën dhe angazhimin vazhdueshëm në shërbim të anëtarësisë i ka ndarë mirënjohje të veçantë kolegut Shala . Po ashtu edhe Kuvendi i SAF e SAM në këtë komunë e ka shpallur kryetar nderi të këtij Kuvendi z. Sadik Shala në shenjë të respektit për punën dhe përkushtimin e tij nëpër vite në shërbim të anëtarësisë së SBASHK-ut.



Menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri ka dhënë shumë përgjigje në pyetjet e shtruara nga pjesëmarrësit lidhur me të gjitha çështjet dhe angazhimet aktuale të SBASHK-ut. Pas kësaj është kaluar në zgjedhjen e kryetarit të ri të këtij Kuvendi. Ishin të propozuar 3 kandidatë për këtë detyrë dhe pas votimit të fshehtë rezultatet kanë treguar se

kryetar i Kuvendit të SAF e SAM të Suharekës është zgjedhur Murat Bytyqi.

*Edhe në Klinë Kuvend zgjedhor*

Në sallën e takimeve të Kuvendit Komunal të Klinës është mbajtur Kuvendi zgjedhor i SAF e SAM të kësaj komune.

Në hyrje të takimit kryetari i Kuvendit të SAF e SAM , Arif Elezaj ka përshëndetur kryetarin SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj , juristin Blendor Shatri dhe drejtorin e DKA-së së Klinës, z. Hajdin Morina. Pas kësaj Elezaj ka prezantuar para pjesëmarrësve raportin e punës dhe atë financiar. Anëtarët e Kuvendit të SAF e SAM të Klinës kanë aprovuar këto dy raporte dhe kanë lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut në qendër dhe në komunën e Klinës.

Drejtori i DKA-së së Klinës, Hajdin Morina ka lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut dhe është

shprehur se edhe në të ardhmen do të vazhdojnë me bashkëpunimin korrekt mes institucioneve lokale të shtetit dhe SBASHK-ut në Klinë.



Kryetari i SBASHK-ut , Rrahman Jasharaj dhe juristi Blendor Shatri janë përgjigjur në pyetjet e pjesëmarrësve dhe kanë treguar për arritjet e përbashkëta , por edhe për sfidat. Punimet e Kuvendit kanë vazhduar me zgjedhjet. Me vota unanime është rizgjedhur kryetar Arif Elezaj.

Në mbrojtje të institucioneve arsimore dhe të personalitetit të mësuesit

## Mësuesi dhe shkolla kanë mision të shenjtë



Fatkeqësisht edhe në Kosovë në kohët e fundit hetohen tendenca, me a pa qëllim, që të lëndohet personaliteti i mësuesit. Një pjesë e qeveritarëve lokal e qendror duke u përballur me kërkesat e arsyeshme

në SBASHK-ut ata kanë qasje të gabuar sepse në vend që të angazhohen për zgjidhjen e kërkesave ata në paraqitjet e tyre publike dhe përmes telalëve politikë përhapin të pavërteta se gjoja mësimdhënësit nuk bëjnë asgjë tjetër përveç që vazhdimisht kërkojnë rritje pagash. U tentua të lëndohet personaliteti i mësuesit në forma të ndryshme dhe këto përpjekje nuk ishin të pakta. Kur këtyre tendencave për të lënduar personalitetin e mësuesit ia shtojmë edhe bisedat e përditshme në ndeja e në familje e në prani të fëmijëve me plot fjalë kritikash të pavend e me fyerje për mësuesin atëherë pse të habitemi pse ka rënë shumë disiplina në shkollat tona. Pse po habitemi kur

prindërit dhe nxënësit kanë marrë guxim të që sillen në shkollë si u teket atyre e në emër të të drejtave të fëmijëve dhe të prindërve. Kjo situatë dhe qasja e gabuar ndaj arsimit ka bërë që shkollat dhe të punësuarit në to të jenë plotësisht të pambrojtur nga tekat e një pjese të nxënësve dhe prindërve. Janë duke u shtuar edhe rastet e ofendimeve të rënda e besa edhe të sulmeve fizike ndaj mësuesit dhe institucionit arsimor.

SBASHK-u do të shtojë angazhimet dhe veprimet për të mbrojtur shkollën, që pushtetarët ia kanë marrë plotësisht autonominë. Do ta mbrojë edhe mësuesin nga tendencat në rritje për ta lënduar atë dhe profesionin e shenjtë të tij. SBASHK-u kujton qeveritë lokale dhe qendrore dhe institucionet e sigurisë se duke lënduar vetë apo duke lejuar të tjetrit që ta cenojnë shkollën dhe mësuesin po bëjnë mëkatim më të madh sepse mësuesi me personalitetin e cenuar e të lënduar dhe duke mbetur i pa mbrojtur vështirë se mund ta kryej n mirë misionin e tij për arsimimin dhe edukimin e brezave, thuhet në kumtesën e SBASHK-ut.

## Në disa komuna u mbajtën Kuvende pune të SAF e SAM Gatishmëri për realizimin e detyrave konkrete

Me qëllim që të zhvillohet bashkëbisedë me anëtarësinë për të gjitha çështjet aktuale, po realizohet edhe agjenda e SBASHK-ut me takime pune të Kuvendeve të SAF e SAM.



Deri tani Kuvende të tilla janë mbajtur në Prishtinë, Gjilan, Pejë, Podujevë dhe Viti. Kryetarët e këtyre Kuvendeve Ahmet Pllana, Blerim Mehmeti, Isuf Lajçi, Fadil Halimi dhe Kemajl Bislimi kanë shpalosur fillimisht angazhimet sindikale në komunat e tyre e pastaj duke përshëndetur përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë hapur bashkëbisedën me pjesëmarrësit. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, menaxheri për financa dhe administratë e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe juristi Blendor Shatri u janë përgjigjur pyetjeve të shtruar nga pjesëmarrësit në këto Kuvende pune.



Ata kanë kujtuar edhe angazhimet aktuale të SBASHK-ut duke u ndalur te reagimi me kohë dhe versioni konkret i SBASHK-ut lidhur me Projektligjin për pagat dhe te Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta.

E përbashkëta e këtyre Kuvendeve të punës është se në të gjitha këto komuna të punësuarit në arsim çmojnë lartë angazhimet e SBASHK-ut dhe vlerësojnë arritjet. Gëzon uniteti sindikal dhe përkushtimi që bashkërisht të realizohen kërkesat aktuale të anëtarësisë

Aktivitete të shtuara ndërkombëtare të SBASHK-ut

## Pjesëmarrje në punimet e Komiteteve të ETUCE dhe në EI

Përkushtimi për realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe arritjet e vazhdueshme kanë bërë që SBASHK-u të gëzojë respekt edhe në nivelin ndërkombëtar. Kjo dëshmohet me faktin se në shumë aktivitete të sindikatave të arsimit në nivel të Evropës e që është ftuar edhe SBASHK-u. Do të veçuar ftesën për pjesëmarrje në punimet e Komitetit të ETUCE për Arsim të Lartë dhe Hulumtim, në punimet e Komitetit

të ETUCE për Barazi dhe në Punëtorinë E EI-së për Kushtet e cilësisë së punës në arsim.





SBASHK do të ketë prezantim dinjitoz në këto takime të Komiteteve Evropiane të Sindikatave të Arsimit dhe duke shpalosur para kolegëve nga e tërë Evropa

përvojën, arritjet dhe sfidat e SBASHK-ut dhe duke marrë përvoja me vlerë nga shumë shtete

pjesëmarrëse, përvojë kjo që do të bartet pastaj të anëtarësia e SBASHK-ut.

## Disa nga ngjarjet tjera në muajin shkurt Takim i Kryesisë Ekzekutive të BSPK –së


Pas nënshkrimit të Memorandunit të mirëkuptimit mes SBASHK-ut dhe BSPK-së, kryetari i SBASHK-ut mori pjesë në takimin e rregullt të Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së. Në këtë takim, që udhëhiqej nga kryetari Haxhi Arifi, janë debatuar shumë çështje që kanë të bëjnë me realizimin e kërkesave të anëtarësisë.



U shpreh shqetësim pse po shtyhet nisja e zbatimit të Ligjit për sigurime shëndetësore dhe një varg vërejtjesh i janë bërë edhe projektligjit për pagat. Është thënë se dallimi 1 me 11 në paga është i patolerueshëm dhe se një gjë e tillë nuk ka ndodhur as në sistemet e kaluara. U tha se është koha për angazhim konkret lidhur me ngritjen e pagave. Kryesia ekzekutive mori vendim që të gjitha këto kërkesa e shqetësime të bëhen publike përmes një konference me mediet.

### GIZ organizoi punëtori lidhur me testin PISA

Në ambientet e GIZ është organizuar një punëtori lidhur me testin PISA në të cilën kanë marrë pjesë ekspertë nga Gjermania ,përfaqësuesi i SBASHK –ut ,drejtorë shkollash, njohës të arsimit dhe mësimdhënës nga komunat e Kosovës.



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj ka treguar se janë duke bërë angazhim konkretet duke shpërndarë posterë dhe fletëpalosje lidhur me testin PISA gjithnjë në përpjekje që të mobilizohen të gjithë me qëllim që në PISA të radhës të shënohen rezultate të tjera. Ai ka treguar se në përgatitjen dhe botimin e posterëve dhe fletëpalosjeve kanë mbështetjen e GIZ-it.

### Direktivat e BE-së në fushën e punës



Ka nisur agjenda e takimeve të partnerëve socialë dhe të përfaqësuesve nga BE-ja me qëllim që të bëhet një përshtatje e Ligjit të punës

në Direktivat e BE-së. Në këtë takim u tha se janë 17 direktiva që pritet të përshtaten (transponohen) me Ligjin e punës. Këto direktiva janë të ndara në pako apo kapituj dhe në takimin e parë është folur lidhur me pakon e parë e që flet për orarin e plotë të punës, për pushimin ditor, javor dhe pushimin vjetor dhe për mundësinë e ndarjes së pushimit të lehonisë mes të dy prindërve.

